

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### OBJEKTI: TRANSPORTI I MBETJEVE URBANE NGA QYTETI I PRRENJASIT NË INCENERATOR (ELBASAN)

Bashkia ka si qëllim ofrimin e transportin e mbeturinave urbane për në inceneratorin e Elbasanit të cilat grumbullohen nga pastrimi i territorin e saj me standarte dhe përformancë sa më të larta, duke siguruar reduktimin e impakteve negative të mbetjeve në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.

E rëndësishme

Llogarita e kostos për shërbimin e transportit të mbeturinave për shërbimin e transportit të mbetjeve në inceneratorin e Elbasanit do të bëhet sipas "Planit Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Prrenjas 2020-2024" të miratuar sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Prrenjas nr.31 datë 07.02.2020.

#### 1. Transportimi i Mbetjeve

Kompania private duhet të kryejë transportin e mbeturinave të produhuara nga banorët e qytetit Prrenjas dhe të njësive administrative. Aktualisht prodhohen respektivisht 8 ton/ditë mbetje urbane, dhe frekuanca e grumbullimit dhe dërgimit i tyre në inceneratorin Elbasanit do të realizohet çdo ditë.

Nr.	Emërtimi	Frekuenca e transportimit të mbetjeve dite ne jave	Gjenerimi (Ton/dit)	Distanca në km në landfill Vajtje-ardhje
1	Transport i mbetjeve urbane	7	8	106

#### 2.Mjeti i transportit

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale,

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkura për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë

*2.a Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës deri ne 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, me standarte Euro 4 jo më pak se 1(një) copë; Kjo ne proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka per qëllim uljen e nivelit të ndotjes që shkaktohet në ajër. Respektimin e normativës së ndotjes në ambjent, meqënëse janë mjete teknologjike qe punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit I ndryshuar me VKM Nr.154 date 27.02.2019 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.*

*2.b Makinë teknologjike transportuese rezerve ne raste avarie , me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, me standarte Euro 4 jo më pak se 1 (nje) copë ; Kjo ne proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis dhe ka per qëllim uljen e nivitet të ndotjes që shkaktohet në ajër .Respektimin e normativës së ndotjes në ambjent, meqenëse janë mjete teknologjike qe punojnë me kohë të zgjatur në qytet dhe për të pasur një nivel të ulët ndotjeje në respektim dhe të normativave teknike të Komunitetit European dhe V.K.M Nr .633 datë 26.10.2018 të Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit Mjedisit I ndryshuar me VKM Nr.154 date 27.02.2019 "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorrike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete.*

## **2.1 Rregulla të tjera për mjetet:**

- a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratuues për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të janë të identifikuara nga Autoriteti kontratuues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt.
- c. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të janë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- d. Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezifikohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- e. Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave .
- f. Autoriteti kontratuues do të inspektojë gjatë ose pas përfundimit të shërbimit, për të siguruar rigorozisht efektivitetin e këtij shërbimi dhe cilësinë e kërkuar.

## **2.2.Kushtet teknike për mjetet e transportit**


- a. Të gjitha mjetet e transportit duhet të janë në gjendje të mirë teknike për të mundësuar transportin e mbeturinave.
- b. Makinat teknologjike duhet të kenë një sistem ngarkimi –shkarkimi të përshtatshëm për transportin e tyre për në incenerator.
- c. Makinat teknologjike duhet të jetë në një gjendje të mire, pa rrjedhje të ndonjë fluidi, dhe në gjendje të punojë 8 orë në ditë në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerje për arësy mekanike. Gjithashtu ato duhet të janë të aftë për të lëvizur me një shpejtësi prej 40 km/h.
- d. Shkarkimet e gazërave të djegies nga makinat teknologjike duhet të janë në përputhje me normat elegjislacionit në fuqi.
- e. Dritat e përparme dhe të pasmet duhet të janë në gjendje të mirë dhe makinat duhet të jetë gjithashtu të pajisur me reflektorë. Dritë të bardhë të pasme për punën gjatë orëve të natës.
- f. Makinat teknologjike duhet të janë të pajisur me pasqyra të jashtme për të pasur një vizion të qartëmbrapa,
- g. Sistemi i ngjeshjes duhet të jetë në gjendje të mirë për të lejuar një shkallë të mirë ngjeshje për tërealizuar ngarkimin-shkarkimin e sasisë së kërkuar të mbeturinave brenda volumit të kamionit (respektivisht 10 ton).

- h. Të gjitha investimet, mirëmbajtja dhe në qoftë se është e nevojshme edhe kostot e zëvendësimit tëpjesëve janë të gjitha për t'u paguar nga kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e të gjitha makinave dhe për faktin që ata duhet të jenë të gjithë në gjendje pune.
- i. Në qoftë se një makinë është jashtë shërbimit, kontraktuesi duhet ta zëvendësojë atë me shpenzimet e tij me një makinë të ngjashme me të përgjatë gjithë kohës së riparimit të saj. Të tilla situate nuk duhet të kenë ndonjë influence apo ndikim mbi sasinë dhe cilesinë e shërbimit të transportit të mbetjeve.
- j. Makinat teknologjike që do të përdoren për transport duhet të lahen cdo ditë dhe të tregohet kujdes për to. Ato duhet të sigurojnë një transport të sigurt, të pastër dhe higjenik të mbetjeve.
- k. Shoferi duhet të mbajë një libër ditor ku të tregojë të gjithë informacionin për punën e bërë cdoditë: orën kur ka filluar transporti, pushimet gjatë shërbimit, orët e shkarkimit, rrugët e bëra dhe kilometrat. Përfaqësues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.
- l. Kompania duhet të ketë gjithashtu një regjistër për çdo makinë teknologjike, ku të jepet i gjithë informacioni në lidhje me karburantin (datat, orët dhe sasitë), vajin dhe të tjera aktivitete të mirëmbajtjes. Përfaqësues të bashkisë mund të kenë akses tek libri ditor sipas kërkesës.
- m. Çdo mjet duhet të jetë i paisur me shuesin e zjarrit 6 kg, trekëndëshin e sigurisë, si dhe krik hidraulik.
- n. Detyrimisht në të gjithë makinat dhe kontenierët duhet të shkruhet "Me ju për një qytet më të pastër".

### 2.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Kontraktuesi duhet ti transportoje mbetjet nga vendepozitimi i tyre "Krasta" e cila do të jetë edhe si pikë tranziti drejt inceneratorit të Elbasanit.
- b. Transporti i tyre do të bëhet nga ora 5:00-11:00
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të transportit të përgatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen nga Autoriteti kontratuves. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratuves këto ndryshime.

**Punoi:**

- 1.Gordana Karaj 
- 2.Rolanda Hasballa 
- 3.Olgert Alla 
- 4.Marseda Vasku 
- 5.Nertila Gura 

